



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO**  
**KOMUNA E DRAGASHIT**  
**DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**

---



**Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për  
projekt buxhetin e Komunës së Dragashit për vitin 2024**

**Shtator, 2023**

## Hyrje

Planifikimi i buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2024 është 12,110,967.00 euro. Në kategorinë e investimeve kapitale janë paraparë 4,498,566.00 euro, në kategorinë e pagave dhe mëditjeve 5,819,434.00 euro, mallra dhe shërbime 1,292,967.00 euro, subvencione dhe transfere 300,000.00 euro, si dhe shpenzime komunale 200,000.00 euro. Në kuadër të buxhetit të paraparë, pjesa më e madhe e planifikimit të të hyrave janë nga Granti Qeveritar (6,607,712.00 euro), Granti Specifik për Arsimin (3,638,070.00 euro), Granti Specifik për Shëndetësinë (1,400,735.00 euro), si dhe të hyrat vetanake (464,450.00 euro).

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 të 11 shtatorit 2008, si dhe nenit 6 pika 1.3 UA (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Qarkores 2024/01 dhe Qarkores 2024/02 të Ministrisë së Financave, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, në koordinim me kryetarin e Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, në bashkëpunim edhe me zyrtarët dhe drejtorët e drejtorive komunale, Grupin Punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës, si dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, kanë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për vitin 2024.

Përgatitja e raportit është bërë duke u bazuar edhe në nenin 9, pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Në këtë raport mund të gjeni të dhëna që nga mbajtja e dëgjimit publik dhe mënyra e marrjes së kërkesës nga ana e qytetarëve (formë fizike, elektronike dhe në takimin direkt të mbajtur në lokalitet).

Me qëllim të informimit të qytetarëve për mundësitë buxhetore dhe planifikimet paraprake të ndarjeve buxhetore në projekt buxhetin e komunës për vitin 2024, Grupi Punues ka përgatitur një dokument të veçantë me informata të përgjithshme për projekt buxhetin dhe ndarjet fillestare buxhetore të planifikuara për investimet kapitale.

## Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2023

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, me datë 10.02.2023 kryetari i Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, ka nënshkruar Vendimin për formimin e grupit punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e Komunës së Dragashit për vitin 2024. Me qëllim të zgjerimit të anëtarëve në Grupin Punues, me datë 16.06.2023 ka plotësuar Vendimin paraprak të Grupit Punues, nga tre (3) sa ishin paraparë me vendimin e parë, në nëntë (9) anëtarë: Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, Lindita Kozmaqi Piraj – ZBGJ, Arben Skenderi – zyrtar financiar nga Drejtoria e Shëndetësisë, Bean Hadziasan – drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Ambientit, Nuhia Tairovci – Drejtoria për Shërbime Publike, Fari Kolloni – Zyra për Informim, Burim Aliu – Zyrtar Kryesor Financiar, Uzair Hamza – shef i Zyrës për Komunitete, si dhe Kaltrina Krasniqi – zyrtare për Buxhet në Drejtorinë e Arsimit.

Procesit të hartimit të projekt buxhetit të vitit 2024 i ka paraprirë miratimi i Konizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026. Në kuadër të takimit të parë publik me qytetarë, të mbajtur më 14.06.2023, është diskutuar dhe prezantuar Draft Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026. Në këtë proces, Zyra për Informim ka qenë e angazhuar në përpilimin e procesverbalit të takimit të parë publik me qytetarë dhe dokumenti i tillë është publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës së Dragashit.

Në suaza të ecurisë dhe planifikimit sa më të mirë të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues ka hartuar Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore, ku si i tillë është përcjellë edhe me ftesat publike dhe informimi në kohë për ndryshimet që kanë ndodhur gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore. Ftesat dhe informatat për organizimin e dëgjimeve buxhetore janë publikuar në uebfaqen zyrtare të Komunës (Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/category/takimet-dhe-degjimet-publike-buxhetore/njoftimet-takimet-dhe-degjimet-publike-buxhetore/> ; Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/category/sastanaci-i-javne-budzetske-rasprave/obavestenja/> ) si dhe në mekanizma tjerë alternativë, të tilla si rrjeti social Facebook ( <https://www.facebook.com/profile.php?id=100066575766996> ).

Krahas planifikimit të dëgjimeve buxhetore me prezencë fizike, Komuna e Dragashit ka synuar që projekt buxheti i vitit 2024 të jetë në konsultim edhe përmes formave elektronike, duke u dhënë mundësi qytetarëve të kenë qasje në këto dokumente. Për më tepër, Qarkorja Buxhetore 01 dhe Qarkorja Buxhetore 02 janë publikuar në uebfaqen e Komuës. (Qarkorja 01: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Qarkorja-01.pdf> )

[Buxhetore-2024\\_01-1.pdf](#) ; Qarkorja 02: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Qarkorja-Buxhetore-2024-02-1.pdf> ).

Njoftimet për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë janë publikuar brenda afateve ligjore në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetin social Facebook. Në fund të secilit njoftim janë publikuar emailat e zyrtarëve ku qytetarët kanë pasur mundësi t'i dërgojnë kërkesat dhe sugjerimet e tyre. Njoftimet janë publikuar në gjuhët zyrtare. Çdo vonesë eventuale në publikimin e njoftimeve për dëgjimet buxhetore në uebfaqen zyrtare të Komunës së Dragashit ka qenë për shkak të problemeve me funksionimin e uebfaqes.

### **Njoftimet e publikuara në uebfaqen e Komunës:**

#### **Shqip:**

1. Kalendar i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Kalendar-Shqip.pdf>

2. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Blaç, Zaplluxhe, Zgatar:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Blac.pdf>

3. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brodosanë, Kuklibeg, Kuk, Buzez, Pllajnik, Kosavë, Kapre:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Brodosane.pdf>

4. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Bellobrad, Brrut, Zym, Qollopek:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Bellobrad-1.pdf>

5. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brezne, Buqe, Plavë, Rrenc:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Brezne.pdf>

6. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me gra dhe vajza, të rinj, pensionistë dhe grupe me qytetarë nga komunitetet (goran dhe boshnjak):

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Gra.pdf>

7. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e Dragashit, Xërxes, Shajnes, Radeshës, Leshtanit, Kukajanit, Libevishtës, Mlikës, Vranishtës, Rapçës:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Dragash.pdf>

8. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brod, Baçkë, Dikancë:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Brod.pdf>

9. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Krushevë, Glloboqicë, Orqush, Kërstec, Zlipotok:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Krusheve.pdf>

10. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatit Restelicë:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Restelice.pdf>

### **Boshnjakisht:**

1. Kalendar i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Kalendar-Boshnjakisht.pdf>

2. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Blaç, Zaplluxhe, Zgatar:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Blac-1.pdf>

3. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brodosanë, Kuklibeg, Kuk, Buzez, Pllajnik, Kosavë, Kapre:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Brodosane.pdf>

4. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Bellobrad, Brrut, Zym, Qollopek:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Bellobrad.pdf>

5. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brezne, Buqe, Plavë, Rrenc:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Brezne.pdf>

6. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me gra dhe vajza, të rinj, pensionistë dhe grupe me qytetarë nga komunitetet (goran dhe boshnjak):

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Gra.pdf>

7. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e Dragashit, Xërxes, Shajnes, Radeshës, Leshtanit, Kukajanit, Libevishtës, Mlikës, Vranishtës, Rapçës:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Dragash.pdf>

8. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brod, Baçkë, Dikancë:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Brod-2.pdf>

9. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Krushevë, Gllloboqicë, Orqush, Kërstec, Zlipotok:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Krusevo.pdf>

10. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatit Restelicë:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Rstelica.pdf>

### **Njoftimet e publikuara në faqen zyrtare në Facebook të Komunës së Dragashit:**

#### **Shqip:**

1. Kalendar i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=633091635586690&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

2. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Blaç, Zaplluxhe, Zgatar:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=637447471817773&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

3. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brodosanë, Kuklibeg, Kuk, Buzez, Pllajnik, Kosavë, Kapre:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=637941415101712&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

4. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Bellobrad, Brrut, Zym, Qollopek:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=638768865018967&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

5. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brezne, Buqe, Plavë, Rrenc:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=640486194847234&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

6. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me gra dhe vajza, të rinj, pensionistë dhe grupe me qytetarë nga komunitetet (goran dhe boshnjak):

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=640956018133585&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

7. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e Dragashit, Xërxes, Shajnes, Radeshës, Leshtanit, Kukajanit, Libevishtës, Mlikës, Vranishtës, Rapçës:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=641410261421494&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

8. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brod, Baçkë, Dikancë:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=641886638040523&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

9. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Krushevë, Glloboqicë, Orqushë, Kërstec, Zlipotok:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=643065837922603&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

10. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatit Restelicë:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=643784637850723&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

### **Boshnjakisht:**

1. Kalendari i organizimit të dëgjimeve buxhetore:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=633095922252928&set=pb.100066575766996.-2207520000>

2. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Blaç, Zaplluxhe, Zgatar:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=637448771817643&set=pb.100066575766996.-2207520000>

3. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brodosanë, Kuklibeg, Kuk, Buzez, Pllajnik, Kosavë, Kapre:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=637952018433985&set=pb.100066575766996.-2207520000>

4. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Bellobrad, Brrut, Zym, Qollopek:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=638777341684786&set=pb.100066575766996.-2207520000>

5. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brezne, Buqe, Plavë, Rrenc:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=640486731513847&set=pb.100066575766996.-2207520000>

6. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me gra dhe vajza, të rinj, pensionistë dhe grupe me qytetarë nga komunitetet (goran dhe boshnjak):

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=640957354800118&set=pb.100066575766996.-2207520000>

7. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e Dragashit, Xërxes, Shajnes, Radeshës, Leshtanit, Kukajanit, Libevishtës, Mlikës, Vranishtës, Rapçës:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=641411694754684&set=pb.100066575766996.-2207520000>

8. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Brod, Baçkë, Dikancë:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=641887171373803&set=pb.100066575766996.-2207520000>

9. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatrave Krushevë, Gllloboqicë, Orqushë, Kërstec, Zlipotok:

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=643066704589183&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

10. Njoftimi për organizimin e dëgjimit buxhetor me banorët e fshatit Restelicë:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=643785561183964&set=pb.100066575766996.-2207520000>



Grupi punues, në kuadër të ndarjes së përgjegjësisë dhe ndërmarrjes së aktiviteteve për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e konsultimit publik për projekt buxhetin e Komunës, kishte planifikuar shfytëzimin e databazës së konsultimeve publike për të targetuar grupe të ndryshme qytetare dhe përfshirjen së tyre në proces të konsultimeve publike. Në këtë kontekst, Grupi Punues përmes Zyrës për Informim, përmes komunikimeve elektronike ka dërguar mbi 40 ftesa të personalizuar për grupe të ndryshme qytetare, përfshirë: OJQ, biznese, përfaqësues të organizatave rinore, anëtarëve të Kuvendit të Komunës etj.

Bazuar në Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore, Grupi Punues në koordinim me ekzekutivin e Komunës ka planifikuar të mbajë 9 dëgjime buxhetore, nga data 16 gusht deri më 25 gusht 2023. Dëgjimi i parë buxhetor i planifikuar që të mbahet në fsh. Blaç (me banorët e fshatrave Zaplluxhe, Blaç, Zgatar) më datë 16.08.2023, është anuluar për shkak të angazhimit dhe agjendës së ngarkuar të kryetarit të Komunës. Banorët e fshatrave Blaç dhe Zaplluxhe janë njoftuar për anulimin, si dhe janë njoftuar për të marrë pjesë në dëgjimin buxhetor të planifikuar për t'u mbajtur një ditë më pas në fshatin Brodosanë. Ndërkaq, banorët e fshatit Zgatar janë njoftuar për të marrë pjesë në dëgjimin buxhetor të mbajtur në fshatin Bellobrad, më datën 18.08.2023.

#### **Tabela me të dhënat e përgjithshme**

Metodat e konsultimit	Data / Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Brodosanë, me banorët e fshatrave Brodosanë, Zaplluxhe, Blaç, Kuklibeg, Kuk, Buzez, Pllajnik, Kosavë, Kapre	17.08.2023, 2 orë	45 pjesëmarrës	8 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Bellobrad, me banorët e fshatrave Bellobrad, Zgatar, Brrut, Zym, Qollopek	18.08.2023, 2 orë	22 pjesëmarrës	6 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime

Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Brezne, me banorët e fshatrave Brezne, Buqe, Plavë, Rrenc	21.08.2023, 2 orë	12 pjesëmarrës	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në Dragash me grupet e nënpërfaqësuar (gra, të rinj, pensionistë,grupe nga komunitetet etj)	22.08.2023, 2 orë	53 pjesëmarrës	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në Dragash, me banorët e Dragashit, Xërxes, Shajnes, Radeshës, Leshtanit, Libevishtës, Kukajanit, Mlikës, Vranishtës, Rapçës	22.08.2023, 2 orë	24 pjesëmarrës	12 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Gllloboqicë, me banorët e fshatrave Gllloboqicë, Krushevë, Orqush, Kërstec, Zlipotok	24.08.2023, 2 orë	10 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Restelicë, me banorët e fshatit Restelicë	25.08.2023, 2 orë	15 pjesëmarrës	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Takim i drejtpërdrejtë në fshatin Brod, me banorët e fshatrave Brod, Baçkë, Dikancë	26.08.2023, 2 orë	18 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime
Publikimi në ueb faqe / platforma elektronikë	15 ditë	2 pjesëmarrës	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa, komente/sugjerime

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike ( të drejtpërdrejta) si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt buxheti i vitit 2024, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri më **15 shtator 2023** do të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Dragashit.

**Shtojca – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.**

**Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Zaplluxhe, Blaç, Brodosanë, Kuklibeg, Kuk, Buzez, Pllajnik, Kosavë, Kapre**

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Investime në shtëpinë e shëndetit në Brodosanë;	Halit Reshiti – banor i fshatit Brodosanë	Pranohet	Është shpallur tenderi për renovimin e QMF-së në fshatin Brodosanë dhe këtë vit do të fillojnë punimet
2.	1. Trasimi i rrugës “Ndërlivadhet” në fshatin Brodosanë	Miran Mustafa – banor i fshatit Brodosanë	Pranohet	Projekti për hapjen dhe trasimin e kësaj rruge do të bëhet në bashkëpunim me LMT-në e KFOR-it Turk, Njësia në Dragash
3.	1. Të bëhet rregullimi i disa rrugëve në fshatin Pllajnik  2. Të ndërtohen mure mbrojtëse në disa vende ku ka nevojë	Idriz Qusaj – Banor i fshatit Pllajnik	Pranohet  Pranohet	Komuna do të ndajë mjete në buxhetin e vitit 2024 për rregullimin e disa rrugëve të asfaltuara në disa fshatra, ku përfshihet edhe fshati Pllajnik  Këtë vit në për fshatin Pllajnik do të investohen afër 50 mijë euro, ku një pjesë e mjeteve do të shpenzohen edhe për këtë qëllim
4.	1. Ambulanta e fshatit Kuk është në gjendje të keqe. Duhet të investohet, sidomos në te rrethojat	Kapllan Fetahu – banor i fshatit Kuk	Pranohet	Aktualisht është duke u investuar në renovimin e disa QMF-ve dhe AMF-ve në disa fshatra. Do të bëjmë përpjekje që ta fusim në projekt edhe Ambulantën e fshatit Kuk

	2. Është mirë të bëhet edhe rruga Kosavë-Kuk		Pranohet pjesërisht	Do të shikohen mundësitë buxhetore për të bërë realizimin e këtij projekti
5.	1. Te Shtëpia Malore në Bresanë, është më serioze të çohet edhe rryma atje, sepse pa rrymë nuk do të na duhet edhe Shtëpia Malore	Betim Opoja - banor i fshatit Bresanë	Pranohet	Për këtë projekt do të ndahen mjete në buxhetin e planifikuar për vitin 2024
6.	1. Duhet të intervenohet në riparimin e rrugës nëpër fshatin Kosavë  2. Mungon një stadium i vogël në fshatin Kosavë  3. Duhet të bëhet ndriçimi publik në fshatin Kosavë	Sefidin Mejjini - banor i fshatit Kosavë	Pranohet  Pranohet  Pranohet	Në kuadër të shpenzimeve kapitale për vitin 2024 do të planifikohen mjete për riparimin e disa rrugëve të asfaltuara në disa fshatra, ku do të përfshihet edhe fshati Kosavë  Do të shqyrtohen mundësitë që nga mjetet e fituara nga Granti i Performancës të ndahen mjete për realizimin e disa projekteve të vogla nëpër fshatra  Projektet për instalimin e ndriçimit publik nëpër fshatrat e Komunës së Dragashit janë duke u realizuar. Për këtë qëllim do të planifikohen mjete edhe për instalimin e ndriçimit publik në fshatin Kosavë
7.	1. Kemi problem me ujin në fshatin Buzez. A do të ketë mundësi që	Arben Zyberi - banor i fshatit Buzez	Pranohet pjesërisht	Komuna është duke e vazhduar projektin e Ujësjellësit kryesor nga

	Komuna të na lidhë me gypat e Ujësjetës kryesor që do të ndërtohet			qeverisja e kaluar dhe në këtë projekt nuk është i përfshirë fshati Buzez. Do të shqyrtohen mundësitë që të lihet një dalje për kyçje në këtë Ujësjetës edhe të fshatit Buzez. Për zgjidhjen e tërësishme të problemit të ujit në fshatin Buzez do të planifikohen mjete në vitin 2025.
8.	1. Mbledhja e ujrave në Rrugën e Zgatarit ku do të bëhet kubëzimi	Visar Veseli - banor i fshatit Bresanë	Pranohet	Në kuadër të projektit të kubëzimit të kësaj rruge do të planifikohen mjete për këtë qëllim

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-ne-fshatin-brodosane/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/danas-je-odrzana-budzetska-rasprava-u-selu-brodosane/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0T6mAd27NYYocqy4KrTN6hkjLPkK9yCaHTzPbGCs1ApkLGM8jLicQTZCbGDFcU9TG1&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0T6mAd27NYYocqy4KrTN6hkjLPkK9yCaHTzPbGCs1ApkLGM8jLicQTZCbGDFcU9TG1&id=100066575766996)

Boshnjakisht: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid04jEhX872ar8oct93kfhUgBehcgtnK8Kg6nvNDZoRLtBNjoimAfmj5RoSjmVFdiS9l&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid04jEhX872ar8oct93kfhUgBehcgtnK8Kg6nvNDZoRLtBNjoimAfmj5RoSjmVFdiS9l&id=100066575766996)

**Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Bellobrad, Zgatar, Brrut, Zym, Qollopek**

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Si do bëhet shpërndarja e rrjetit të Ujësjellësit në fshatin Bellobrad	Vetim Sadikaj - kryetar i fshatit Bellobrad	Pranohet	Komuna është duke e implementuar projektin ekzistues të Ujësjellësit nga qeverisja e kaluar. Secili fshat do ta ketë gypin e vet nga do të furnizohet dhe do të uji do të zbrazet në rezervarin ekzistues
2.	1. Për fshatin Zym, përveç kanalizimit, për çfarë projekte të tjera do të investohet	Rinor Qollopeku - banor i fshatit Qollopek	Pranohet	Për fshatin Zym është planifikuar që të ndahen mjete edhe për kubëzimin e rrugëve të Rruga e Xhamisë
3.	1. Kemi nevojë për ndërtimin e një ministacioni për autobusët në fshatin Zym	Fehmi Selaj - banor i fshatit Zym	Pranohet pjesërisht	Për investime në rrugët ku është kompetente Ministria e Infrastrukturës, Komuna do të shqyrtojë mundësitë e bashkëpunimit me këtë ministri për realizimin e kërkesave të tilla
4.	1. Nëse ka mundësi të bëhet një zgjidhje për mbeturinat në fshatin Bellobrad. Kemi disa shtëpi në fshat që hedhin mbeturinat në hapësira publike dhe ato kundërmojnë erë të keqe	Beqir Beqaj - banor i fshatit Bellobrad	Pranohet	Komuna është duke e hartuar Rregulloren e re për menaxhimin e mbeturinave dhe me këtë Rregullore do të reformohet në tërësi sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Dragashit, përfshirë edhe fshatin Bellobrad
5.	1. Ju sugjerojmë që të bashkëpunoni me kryesinë e fshatit Zgatar	Xhemali Iljazi - banor i fshatit Zgatar	Pranohet	Lista e investimeve kapitale nëpër fshatra është preliminare dhe specifikimi i

	për realizimin e projekteve që lidhen me këtë fshat. Kryesia e fshatit është legjitime dhe është linjë kryesore e bashkëpunimit me Komunën e Dragashit			projekteve konkrete, bashkë me planifikimin e buxhetit do të bëhet konform kërkesave dhe në bashkëpunim me këshillat e fshatrave
6.	1. Kërkojmë që të shikoni cilësinë e punimeve më tepër dhe të siguroni që mbikëqyrësit e punimeve gjatë realizimit të projekteve në fshatin Bellobrad të jenë më profesionistë dhe të angazhuar në sigurimin e cilësisë së punimeve	Sehar Qafleshi – banor i fshatit Bellobrad	Pranohet	Komuna cakton mbikëqyrës dhe menaxher për secilën kontratë të nënshkruar dhe në vazhdimësi inspekton punimet që kryhen nëpër lokalitetet e caktuara. Do të angazhohemi që cilësia e punimeve të jetë çdo herë konform të gjitha kriterëve të parapara.

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-ne-bellobrad/>  
 Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/danas-je-u-belobradu-odrzana-budzetska-rasprava/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid02nCG7cHcoYkbuFsDYVuDGAKWRYoeHc32LLEXmQBZ6CYxw5VpnwexNZbrbT7aRy5qol&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02nCG7cHcoYkbuFsDYVuDGAKWRYoeHc32LLEXmQBZ6CYxw5VpnwexNZbrbT7aRy5qol&id=100066575766996)  
 Boshnjakisht: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid079noBxSyPvhDszgiJ581DzGoAAi2zuUQuiiHpF3qnP9sFuKxFtuDJ9cURzGvpBAXl&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid079noBxSyPvhDszgiJ581DzGoAAi2zuUQuiiHpF3qnP9sFuKxFtuDJ9cURzGvpBAXl&id=100066575766996)



## Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Brezne, Buqe, Plavë, Rrenc

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Te lagjja e re është rryma shumë e dobët, a mund të futet në Draft Buxhet intervenimi për këtë çështje	Hajri Gashi – kryetar i fshatit Brezne	Refuzohet	Intervenimi në trafo Komunës nuk i lejohet. Ekziston vendim me shkrim nga Qeveria
2.	1. Nëse është mundësia, kur të bëhet rishikimi i buxhetit, të bëhet rritje e buxhetit për fshatin Rrenc, sepse për këtë fshat janë ndarë vetëm 10 mijë euro dhe jemi pak të diskriminuar	Mehadin Gërdellaj – banor i fshatit Rrenc	Refuzohet	Nuk janë 10 mijë euro për fshatin Rrenc, po janë 23 mijë euro. Gjithashtu, fshati Rrenc është përfitues i projektit të Ujësllësit kryesor dhe hapjes së rrugës Kapre-Rrenc, si dhe projektit të rregullimit të rrugëve të asfaltuara brenda fshatit
3.	1. Të intervenohet në rrugën lidhëse të fshatit Plavë me fshatin Buqe  2. Të ndërtohet trotuari përgjatë rrugës në Tyrbe të Plavës	Remzi Misini – banor i fshatit Plavë	Pranohet  Refuzohet	Për kubëzimin e disa rrugëve në fshatin Plavë janë planifikuar mjete në Draft Buxhetin e vitit 2024  Për ndërtimin e trotuarit përgjatë kësaj rruge nuk ka vend të mjaftueshëm

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-ne-fshatin-brezne/>  
Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/naredna-budzetska-rasprava-odrzana-je-danas-u-selu-brezne/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid035ReEDfZKDg8gHtnJGfp39WxKenYs72jXAYVYr54v4vwUGNPrxa64djbK2J5nczsSl&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid035ReEDfZKDg8gHtnJGfp39WxKenYs72jXAYVYr54v4vwUGNPrxa64djbK2J5nczsSl&id=100066575766996)

Boshnjakisht: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid025Mq9ZgaWewFuQ6BcxLQwa5mCKw6zq9KY9oTwyQTaCPZycJfrXMMaPyizYv2ABpCl&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid025Mq9ZgaWewFuQ6BcxLQwa5mCKw6zq9KY9oTwyQTaCPZycJfrXMMaPyizYv2ABpCl&id=100066575766996)

**Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me gra dhe vajza, të rinj, pensionistë, grupe me qytetarë nga komunitetet (goran dhe boshnjak)**

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Te ndërtimi i parkut në Dragash, desha të di a do të merrni parasysh që të ketë edhe lojra për fëmijë në këtë park, pasi që në Komunën tonë e kemi shumë të domosdoshme	Lulëbardha Berisha – Qendra për Punë Sociale në Dragash	Pranohet	Ky do të jetë park i lojrave për fëmijë. Lokacionin për ndërtimin e tij ende nuk e kemi caktuar dhe për këtë qëllim do ta bëjmë një debat publik me qytetarët dhe bashkë me ta do të vendoset lokacioni
2.	1. Është e rëndësishme të funksionalizohet Çerdhja e fëmijëve në Dragash. Më intereson të di cila është politika e punësimit për komunitetet joshumicë	Salmira Usmeni – OJQ ‘Sensa’	Pranohet	Buxheti për funksionalizimin e çerdhes dhe për renovimin e objektit është siguruar. Në bashkëpunim me UNICEF-in, Komuna është duke bërë përpjekje që deri kah fundi i vitit 2023 të finalizohet në tërësi projekti i kësaj çerdheje, duke përfshirë edhe stafin, për plotësimin e të cilit do të merret parasysh edhe komuniteti joshumicë
3.	1. Kërkoj mbështetje për renovimin e disa kulmeve të objekteve banesore. Janë disa gra nga komuniteti joshumicë të cilat banojnë në këto objekte	Lindita Kozmaqi Priaj – Zyra për Barazi Gjinore	Pranohet	Komuna i është përgjigjur disa kërkesave në lidhje me renovimin e këtyre kulmeve. Në të ardhmen jemi të gatshëm që të ofrojmë ndihmë në këtë drejtim, me mbështetje të qeverisë qendrore.

	dhe kulmet janë shumë të vjetra			
4.	1. Kemi bërë një kërkesë për sigurimin e transportit për punëtorët e institucioneve publike në Dragash të cilët banojnë në Prizren	Remzije Bojaxhiu – QKMF Dragash	Pranohet pjesërisht	Kjo çështje i përket kompetencave të Ministrisë nga niveli qendror, pasi që lidhet me transportin ndërrurban. Komuna e Dragashit ka dërguar kërkesë zyrtare në ministrinë përkatëse për gjetjen e një zgjidhjeje për transportin e punëtorëve të institucioneve publike në Dragash (relacioni Prizren-Dragash) dhe është në pritje të përgjigjes nga kjo Ministri

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-me-gra-vajza-te-rinj-dhe-pensioniste/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/danas-je-odrzana-rasprava-o-budzetu-sa-zenama-i-devojkama-mladima-i-penzionerima/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid02GRec2scrBm1rdxvHiWTW8X3GpxxgjhRnMSsG5PcsoiU8ftrAaa2jSKdsTg6roPHI&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02GRec2scrBm1rdxvHiWTW8X3GpxxgjhRnMSsG5PcsoiU8ftrAaa2jSKdsTg6roPHI&id=100066575766996)

Boshnjakisht: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0fMPiXnAsSgVCAAtPchGeoBmfcbtMJrQ4cp7hS5p154QztxKnG31A2jP7SDLD3Zvd7l&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0fMPiXnAsSgVCAAtPchGeoBmfcbtMJrQ4cp7hS5p154QztxKnG31A2jP7SDLD3Zvd7l&id=100066575766996)

**Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me banorët e Dragashit, Xërres, Shajnes, Radeshës, Leshtanit, Libevishtës, Kukajanit, Mlikës, Vranishtës dhe Rapçës**

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimin të komenteve është i detyrueshëm)
1.	<p>1. Kërkojmë që të intervenohet në riparimin e kanalizimit mbraza Gjykatës në Dragash dhe një gyp tjetër i kanalizimit që është i dëmtuar, nga Biblioteka deri para Shkollës 'Fetah Sylejmani'</p> <p>2. Problem tjetër është një gyp i ujësjes të lagjja mbraza Spitalit (QKMF-së)</p>	Bekri Qusaj – banor i Dragashit	<p>Pranohet</p> <p>Pranohet</p>	<p>Për zgjidhjen e këtyre problemeve me gypat e kanalizimit do të shikohen mundësitë që të intervenohet përmes projekteve për riparimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve ekzistuese të kanalizimeve</p> <p>Qyteza e Dragashit është pjesë e projektit të ndërtimit të Ujësjes kryesor. Përmes projekteve alternative do të intervenohet edhe në riparimin e rrjetit ekzistues të ujësjes brenda qytezës</p>
2.	<p>1. Prioritet për fshatin Radeshë është investimi në disa rrugë të fshatit</p> <p>2. Një problem tjetër për fshatin Radeshë është mungesa e parkingjeve</p>	Selldin Jelmazi – banor i fshatit Radeshë	<p>Pranohet</p> <p>Pranohet pjesërisht</p>	<p>Për vitin 2024 Komuna planifikon që të ndajë buxhet për kubëzimin e disa rrugëve brenda fshatit Radeshë, si dhe ndërtimin e mureve mbrojtëse përreth rrugëve</p> <p>Mungesa e parkingjeve është evidente edhe nëpër fshatrat e tjerë të Gorës. Komuna është e gatshme që të ndihmojë në këtë drejtim, por në bashkëpunim me banorët e fshatit Radeshë.</p>

				Qytetarët duhet të gjejnë vende adekuate dhe ku ligjërisht na mundësohet që të investojmë në ndërtimin e këtyre parkingjeve
3.	<p>1. A ka ndonjë plan konkret për zhbllokimin e rrugëve në qytezën e Dragashit</p> <p>2. Çfarë do të bëhet me rrugët e uzurpuara, pronat e interesit publik në Dragash nuk mund të shfrytëzohen</p> <p>3. Në Dragash na duhen polica të shtrirë në rrugë, vozitet shumë shpejt dhe rrezikohet siguria e këmbësorëve</p>	Ajhan Beciri - përfaqësues i fshatit Rapçë	<p>Pranohet</p> <p>Pranohet</p> <p>Refuzohet</p>	<p>Për vitin 2024 janë paraparë 55 mijë euro për ndërtimin e rrugëve në qytezën e Dragashit</p> <p>Komuna do të autorizojë Shërbimin Pronësor-Juridik që të bëjë hulumtimin e pronave të uzurpuara dhe do të marrë masa në këtë drjetim</p> <p>Policat e shtrira në rrugë janë kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës</p>
4.	1. Kërkoj që të riparohet rruga rreth 200 metra te vendi nën Xhaminë. Është me kubëza të vjetëruara dhe është e rrezikshme për vetura	Fergap Zaimi - banor i fshatit Radeshë	Pranohet	Komuna planifikon ndrajen e mjeteve për kubëzimin e rrugëve në fshatin Radeshë për vitin 2024
5.	<p>1. Prioritet në fshatin Mlikë është ndërtimi i një ambulance për fshatin, ku do të punësoheshin edhe 2-3 punëtorë</p> <p>2. Prioritet tjetër për fshatin është kubëzimi i rrugëve</p>	Zinaida Elmazi - banore e fshatit Mlikë	<p>Refuzohet</p> <p>Pranohet</p>	<p>Masterplani i Qeverisë e përcakton në mënyrë të qartë se ku duhet të ketë QKMF, QMF dhe AMF</p> <p>Për vitin 2024 planifikohen të ndahen 15 mijë euro për kubëzimin e rrugëve dhe ndërtimin e murit mborjtës në fshatin Mlikë</p>

	3. Propozoj që të përkrahen dhe subvencionohen gratë të cilat merren me mbrojtjen dhe promovimin e traditës gorane		Pranohet	Komuna e Dragashit shpall thirrje publike për subvencionimin e OJQ-ve të cilat implementojnë projekte që lidhen me promovimin e kulturës dhe traditave nga komunitetet shumicë dhe joshumicë
6.	1. Është bërë hapja e disa puseve për gjetjen e ujit, deri ku ka arritur realizimi i këtij projekti në fshatin Rapçë	Kamber Kamberi – banor i fshatit Rapçë	Pranohet	Projekti është duke vazhduar, janë ndarë mjetet për pompat dhe këtë vit planifikohet që ky projekt do të përfundojë
7.	1. Kërkojmë që ta hiqni fshatin Vranishtë nga projekti i Ujësjiellit kryesor	Elvin Memisi – banor i fshatit Vranishtë	Refuzohet	Projekti i Ujësjiellit kryesor nuk mund të nryshohet. Ky projekt është votuar nga Asambleja Komunale dhe për këtë qëllim janë mbajtur edhe takime me banorët e fshatit Vranishtë, kërkesë e të cilëve ka qenë uji i pijshëm
8.	1. Lista e fshatrave të përfshira në projektin e Ujësjiellit kryesor ka qenë nga viti 2012. Prej atëherë shumë fshatra kanë bërë zgjidhje për ujin. Ato mjete duhet të destinohen për projekte të tjera	Nedžmidin Sejdilar – asambleist i Kuvendit Komunal në Dragash	Refuzohet	Projekti i Ujësjiellit kryesor nuk mund të nryshohet. Ky projekt është votuar nga Asambleja Komunale. Procedurat e tenderimit janë kryer dhe punimet kanë filluar. Mund të kemi probleme me operatorin ekonomik dhe të na padisë në gjykatë
9.	2. Kemi nevojë për polica të shtrira në rrugë	Zuhrem Pajaziti – banor i fshatit Libevishtë	Refuzohet	Policat e shtrira në rrugë janë në kuadër të kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës
10.	1. Fshati Shajne ka ngarkesë të madhe me	Florion Hyseni –	Pranohet	Komuna për vitin 2024 ka planifikuar buxhet për

	Rrugën Unazore, nëse ka mundësi të bëhet zgjerimi i kësaj rruge  2. Të instalohet ndriçimi publik për fshatin Shajne	banor i fshatit Shajne	Pranohet	ndërtimin e Rrugës Unazore në Dragash  Projektet për instalimin e ndriçimit publik nëpër fshatra të Komunës së Dragashit janë duke vazhduar. Në bashkëpunim me qytetarët e fshatit Shajne do të planifikohet buxhet për ndriçimin publik në këtë fshat
11.	1. Propozoj që përgjatë rrugës për në Stadiumin e qytetit të bëhen edhe disa pushimore	Sinap Selmani – banor i Dragashit	Pranohet	Komuna për vitin 2024 ka ndarë mjete për ndërtimin e rrugës për në Stadiumin e qytetit, ndërtimin e trotuareve, instalimin e ndriçimit dhe infrastrukturën përcjellëse në këtë pjesë
12	1. Propozoj që të ndërtohen vende të caktuara për vendosjen e kontenierëve për mbeturina	Nazim Dauti – banor i Dragashit	Pranohet	Komuna është në proces të hartimit të Rregullores së re për menaxhimin e mbeturinave dhe do të shyrtohen mundësitë për zgjidhjen e kësaj çështjeje

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-ne-dragash/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/budzetska-saslusanja-sa-gradjanima-danas-su-nastavljena-u-dragasu/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid07vnUuTQ7tLqWqPcZ4AmWbH7ZZKxc2A25Nktx5JGM1UfuxC4vdkd28BkQV48VLdi7l&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid07vnUuTQ7tLqWqPcZ4AmWbH7ZZKxc2A25Nktx5JGM1UfuxC4vdkd28BkQV48VLdi7l&id=100066575766996)

Boshnjakisht: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0XXxB8JWcrdgiQjC9P7RpTPhp1D22dHpQviiHvMCQi36iJbM2Gy32ZjmdmTktE2wil&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0XXxB8JWcrdgiQjC9P7RpTPhp1D22dHpQviiHvMCQi36iJbM2Gy32ZjmdmTktE2wil&id=100066575766996)

**Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Gllloboqicë, Krushevë, Orqushë, Kërstec, Zlipotok**

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës/ sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Ndërtimi i trotuareve apo policave të shtrira në rrugën regjionale	Vanes Sprotiva – banor i fshatit Gllloboqicë	Pranohet pjesërisht	Rrugët regjionale janë në kuadër të kompetencave të Ministrisë nga niveli qendror. Për këto çështje do të shikohen mundësitë e bashkëpunimit me ministrinë përkatëse
2.	1. Të bëhet hapja e rrugëve fushore, që të kemi më të lehtë qasjen për punimin e tokave dhe sipërfaqeve bujqësore	Xhelil Toru – banor i fshatit Krushevë	Pranohet	Për vitin 2024 Komuna ka planifikuar ndarjen e 28 mijë eurove për ndërtimin e infrastrukturës rrugore në fshatin Krushevë

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-ne-gllloboqice/>  
 Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/danas-je-odrzana-rasprava-o-budzetu-u-globocici/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid024VasCZs37GWbvibugnVklSNMfu8p6aNvDkdR766XMcqo8WZyQbJHYRo1fLSxBRnXl&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid024VasCZs37GWbvibugnVklSNMfu8p6aNvDkdR766XMcqo8WZyQbJHYRo1fLSxBRnXl&id=100066575766996)  
 Boshnjakisht: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0AL8uN4SYVAwmpr87KL74FzmD8crfsQ2h6nD1mFueSHmyrpfP7oe2PXRr5DwphpKWl&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0AL8uN4SYVAwmpr87KL74FzmD8crfsQ2h6nD1mFueSHmyrpfP7oe2PXRr5DwphpKWl&id=100066575766996)



## Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatit Restelicë

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Kemi probleme me tensionin e ulët të rrymës në fshatin Restelicë	Murat Mushka - banor i fshatit Restelicë	Refuzohet	Çështja e rrymës nuk është kompetencë e Komunës
2.	1. Të intervenohet në rrugën 'Llokuv', sepse është shumë e ngushtë, rreth 3 metër. Ka një gjatësi afër 230 metër dhe aty janë ndërtuar 15 shtëpi të reja	Berat Çufta - banor i fshatit Restelicë	Pranohet	Për kubëzimin e rrugëve 'Llokuv' dhe 'Jezerqe' në buxhetin e viti 2024 janë planifikuar 80 mijë euro
3.	1. Rregullimi i çështjes së mbeturinave të ngurta në fshatin Restelicë	Nesim Hodza - Radio Bambus	Pranohet	Rregullorja e re për menaxhimin e mbeturinave është në procesin e hartimit dhe të konsultimit publik. Kjo rregullore do ta reformojë sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Dragashit

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-ne-restelice/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/danas-je-odrzana-rasprava-o-budzetu-sa-mestanima-sela-restelica/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid02XRHjJiaCnx73Vkojo8aZUbnRGSdnNd5mgmuKA134TEKSDb82CvRuFgXAcY2AvTDFI&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02XRHjJiaCnx73Vkojo8aZUbnRGSdnNd5mgmuKA134TEKSDb82CvRuFgXAcY2AvTDFI&id=100066575766996)

Boshnjakisht: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid025p2oASBGxzLs6HmETcWNUqLj3hrb6u2hsyJvfWum8eUf7QNDk8rLATSj4sDumhrRl&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid025p2oASBGxzLs6HmETcWNUqLj3hrb6u2hsyJvfWum8eUf7QNDk8rLATSj4sDumhrRl&id=100066575766996)

### Kërkesat: Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Brod, Baçkë, Dikancë

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Rregullimi i përroit të fshatit Brod	Shefket Ismaili – banor i fshatit Brod	Pranohet	Rregullimi i përroit është planifikuar në buxhetin e vitit 2024, ku do të ndahen mbi 56 mijë euro për kubëzimin e rrugëve dhe rregullimin e përroit të rruga Xhonjet në fshatin Brod
2.	1. Rregullimi i kanalizimit në fshatin Brod	Beadin Azafce – banor i fshatit Brod	Pranohet	Rregullimi i kanalizimit planifikohet të rregullohet përmes projekteve të cilat do t'i përgatisë drejtoria përkatëse

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-ne-brod/>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/sr/news/danas-je-odrzana-budzetska-rasprava-u-selu-brod/>

Vegëza e lajmit për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në Facebook:

Shqip: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0PftdyCNspivB7Azh7ftPZn7LRPSx8KjeGD28VVr6zJrbfhkV3BXYKSncnS7UTsyCl&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0PftdyCNspivB7Azh7ftPZn7LRPSx8KjeGD28VVr6zJrbfhkV3BXYKSncnS7UTsyCl&id=100066575766996)

Boshnjakisht: [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0zqAseNuPRjSofgFjWwMCrfuau19vURoeXMsKJJP4P9zKZc5pTtN6TM2ukeEAa7vfl&id=100066575766996](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0zqAseNuPRjSofgFjWwMCrfuau19vURoeXMsKJJP4P9zKZc5pTtN6TM2ukeEAa7vfl&id=100066575766996)

## Kërkesat e qytetarëve përmes emaileve të publikuar në uebfaqe dhe Facebook zyrtar

Nr	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt buxhetin e vitit 2024	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1.	1. Renovimi i QMF-së në Llopushnik, gjendja është e keqe	Blerim Krasniqi - mjek në QMF të Llopushnikut	Pranohet	Renovimi i QMF-së së Llopushnikut është i përfshirë në buxhetin e këtij vit (2023) dhe së shpejti do të shpallet tenderi për renovimin e saj
2.	1. Të shtrohen rrugët që kanë mbetur pa shtruar  2. Të vazhdohet ndriçimi publik i një pjese të fshatit që ka mbetur, deri te shkolla në Llopushnik	Elvir Krasniqi - banor i fshatit Brezne	Pranohet  Pranohet	Për riparimin e disa rrugëve të asfaltuara dhe kubëzimin e rrugëve të mbetura në fshatin Brezne janë ndarë mjete në buxhetin e vitit 2024  Ndriçimi publik i pjesës së mbetur të fshatit do të bëhet përmes projekteve të veçanta të përgatitura nga drejtoria përkatëse

**Tabela me numrin e pjesëmarrësve sipas gjinisë, numrin e kërkesave dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të Kuvendit Komunal**

Nr.	Vendi i mbajtjes së dëgjimit buxhetor	Numri i pjesëmarrësve sipas gjinisë			Numri i përgjithshëm i kërkesave	Pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit Komunal
		F	M	T		
1.	Brodosanë	2	43	45		3
2.	Bellobrad	2	20	22		2
3.	Brezne	1	11	12		0
4.	Dragash (Dëgjimi me gra...)	39	14	53		1
5.	Dragash (Dragash, Shajne...)	2	22	24		2
6.	Gllloboqicë	0	10	10		2
7.	Brod	0	18	18		1
8.	Restelicë	0	15	15		0
	<b>Totali:</b>	<b>F</b>	<b>M</b>	<b>T</b>	<b>55</b>	<b>11</b>
		<b>46</b>	<b>153</b>	<b>199</b>		

**Vërejtje:** Në dëgjime buxhetore kanë marrë pjesë gjithsej tetë (8) asambleistë nga Kuvendi Komunal në Dragash. Numri 11 i pjesëmarrjes është për shkak se disa asambleistë kanë marrë pjesë në më shumë se një dëgjim buxhetor!

Komuna e Dragashit, 14.09.2023

Përgatiti:  
Fari Kolloni – Zyra për Informim